

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Aeroporti i Milanos merr zyrtarisht emrin “Silvio Berlusconi”
ADRESA	https://tpz.al/aeroporti-i-milanos-merr-zyrtarisht-emrin-silvio-berlusconi-i333884
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 18:01:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 17:54:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2b833c977f23bc4d40db7ca42821a9003f7635f07237214d8d66763efb609893
TEKSTI	4546ceef15eb5b0c869d27a836e239c6ea582d7d07dc35a12b0a4630b95640ca
PAMJA	bc4fa10494c3e3070ef855f3d0bffc2f9301bf81872c20715af2145b178c48ed

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0a0216b8329656a89e2990ffa432f4e75e43d78df1f455c6b3148619960b6da6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	b795f32e8dccad3401c122ecb35fb566e35fee7f00b27116f873c51e2a9a0ff8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/0a0216b8329656a89e2990ffa432f4e75e43d78df1f455c6b3148619960b6da6

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

15:34 Plagosje në Tiranë, 33 vjeçari shkon në spital me plagë të shkaktuara nga arma e zjarrit • 15:15 "Dhunë fizike dhe fyerje"/ Rrëfimi i shefit të Komisarariatit të Krujës pasi e

BOTA, 25 SEPTEMBER 2026, 19:54

Aeroporti i Milanos merr zyrtarisht emrin "Silvio Berlusconi"

tpz.al TPZ



Aeroporti i Malpensas në Itali është emëruar zyrtarisht "Silvio Berlusconi", në nderim të ish-kryeministrit italian dhe themeluesit të Mediaset.

Ceremonia e inaugurimit të emrit të ri u zhvillua mëngjesin e së premtes, 25 shtator, në aeroportin e Vareses, në prani të familjarëve të Berlusconi dhe figurave të larta politike e institucionale.

Në ceremoni ishte e pranishme vajza e tij, Marina Berlusconi, e cila tha se ndihej e emocionuar dhe krenare që aeroporti, i cili pret çdo ditë mijëra udhëtarë nga e gjithë bota, do të mbajë emrin e të atit. Ajo e përshkroi Berlusconi si një njeri që "gjithmonë kërkonte dialogun me të gjithë".

Në emër të familjes foli edhe vëllai i tij, Paolo Berlusconi. Ai u shpreh se aeroporti përfaqëson një portë drejt Europës dhe botës dhe se emërtimi i tij me emrin e Silvio Berlusconi është një mënyrë për të ruajtur kujtimin e tij. "Sot Silvio nuk është më, por është më i gjallë se kurrë", tha ai, duke përmendur trashëgiminë e tij në biznes, sport, media dhe politikë.

Edhe Marta Fascina, ish-partnerja e Berlusconi dhe deputete e Forza Italia-s, reagoi përmes një postimi në Instagram. Ajo shkroi se nga tani, sa herë që një udhëtar do të niset nga aeroporti "Silvio Berlusconi" dhe të ngrihet në qiell, ish-kryeministri do të jetë aty për ta shoqëruar. Fascina iu drejtua edhe kritikëve të Berlusconi, duke thënë se ata do të vazhdojnë ta shohin madhësinë e tij.

Në ceremoninë zyrtare morën pjesë presidenti i Senatit, Ignazio La Russa, presidenti i Lombardisë, Attilio Fontana, si dhe zëvendëskryeministri Matteo Salvini. Ky i fundit e cilësoi Berlusconi një nga sipërmarrësit më të mëdhenj të historisë politike italiane dhe tha se emërtimi nuk është një akt partiak, por një njohje e rolit të tij.

Por ceremonia u shoqërua edhe me polemika për mungesën e kryebashkiakut të Milanos, Giuseppe Sala. Salvini shprehu keqardhje për mungesën e tij, ndërsa Sala tha se kishte

ide!

Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalitet
Nga Mero Baze

Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë
Nga Preç Zogaj

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

kundërshtuar këtë vendim dhe se prania e tij në ceremoni do të ishte në kundërshtim me qëndrimin që kishte mbajtur.

[Shiko të tjera video](#)

BOTA / 25 September 2026, 18:51

[Qyteti i Gjermanisë Lindore ndalon vendosjen e pllakave përkujtimore të Holokaustit](#)

BOTA / 25 September 2026, 17:55

[Skandal me abuzimin e fondeve të investimeve në Turqi, arrestohen 45 persona, mes tyre edhe ish-zv.guvernatori i Bankës Qendrore](#)

BOTA / 25 September 2026, 11:45

[Tensionet/ Alarm në veri të Europës! Forcat suedeze dhe finlandeze zbulojnë avionët ushtarakë rusë mbi Gjirin e Finlandës](#)

BOTA / 25 September 2026, 10:33

[Dekreti/ Italia ndalon burkën dhe nikabin në shkolla, vendos kufi edhe për numrin e nxënësve të huaj](#)

BOTA / 25 September 2026, 10:08

[VIDEO/ Zbardhen prapaskenat e darkës Trump-Xi në Shtëpinë e Bardhë, emrat e fuqishëm që u ulën në të njëjtën tryezë](#)

BOTA / 25 September 2026, 09:31

[Konflikti/ Nga rihapja e Ngushticës së Hormuzit te bisedimet për programin bërthamor, Irani i propozon SHBA-së një plan armëpushimi shtatëditor](#)

BOTA / 24 September 2026, 21:29

Drejtoi platformën që përdorej për shitblerjen e të dhënave personale, 28-vjeçari nga Kosova pranon fajësinë në SHBA për krime kibernetike

BOTA / 24 September 2026, 20:58

Kompania që i shiti Pentagonit softuer për hakimin e telefonave fshehu pronësinë ruse

BOTA / 24 September 2026, 20:56

Pas urdhrit të gjykatësit, Shtëpia e Bardhë rikthen gasjen për mediat e ndaluara nga Trump

BOTA / 24 September 2026, 20:46

Osetia e Veriut nis largimin e qindra veturave të dëmtuara dhe të braktisura nga rusët

BOTA / 24 September 2026, 20:04

Polonia evakuon pikat kufitare, avionët luftarakë vihen në gatishmëri

BOTA / 24 September 2026, 19:25

Izraeli paralajmëron sulm të ri ndaj Iranit: Është çështje kohe...

BOTA / 24 September 2026, 19:10

“Të drejtojmë anijen gjigante të marrëdhënieve Kinë-SHBA” – Presidenti Xi: Jam gati të punoj me Donald Trump

BOTA / 24 September 2026, 19:01

Dyshohet se ka qenë roje i një kampi nazist, Gjermania nis hetimet ndaj një 105-vjeçari

BOTA / 24 September 2026, 18:23

Putin i ftuar në samitin e G20 në Miami, BE planifikon të dënojë sulmin ndaj Ukrainës në takim

BOTA / 24 September 2026, 17:19

Gazeta spanjolle "El Mundo": CIA paralajmëroi Evropën se Rusia po përgatiste sulme me dronë nga Mesdheu

BOTA / 24 September 2026, 17:06

Foshnja e porsalindur humb jetën pas lindjes, 22 punonjës shëndetësorë nën hetim në Itali

BOTA / 24 September 2026, 16:18

E rëndë në Itali/ 6-vjeçari ndërron jetë teksa po hante ushqim

BOTA / 24 September 2026, 15:53

SHBA ftojnë Putinin në samitin e G20 në Miami, reagon Kremlin: Do ta shqyrtojmë

BOTA / 24 September 2026, 14:50

Tërmet 5.1 ballë godet Turqinë, lëkundjet ndihen në Siri dhe Irak

[KONTAKT](#)

[PRIVACY POLICY](#)

[COOKIES](#)

NJOFTIME NGA TPZ.AL 

tpz.al

TPZ.al është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.



Built & Monetized by **Mediadesk**

AKTUALITET

IDE

NË FOKUS

BALLKAN

BOTA

LIFESTYLE

SPORT

TEJ E KETEJ

BLOG

EMISIONE